



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31 Tetor 2022

Nr: 202

V E N D I M

P Ë R

PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT  
ZGJEDHOR E TË ASGJËSIMIT TË FLETËVE TË VOTIMIT PAS HAPJES SË KUTIVE TË  
VOTIMIT DHE KUTIVE TË MATERIALEVE ZGJEDHORE TË PËRDORURA NË  
ZGJEDHJE

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, dhe nenit 178, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Jo më herët se gjashtë muaj pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) hap kutitë e votimit dhe ato të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet në fjalë. Administrimi i dokumentacionit dhe i materialit zgjedhor që gjendet në këto kuti bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim.
2. Fillimi i procedurave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Personat anëtarë të stafit të KQZ-së që do të kryejnë procedurat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm. Kur është e nevojshme mundet të rekrutohet edhe personel shtesë me kohë të pjesshme sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve krijon:
  - a) grupin e punës përgjegjës për hapjen e kutive të votimit dhe të materialeve zgjedhore dhe përcakton kriteret teknike të realizimit të procesit;
  - b) grupin e punës për fshirjen e të dhënave të pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, i cili në fund të procedurës i dorëzon Sekretarit të Përgjithshëm



procesverbalin ku konfirmon fshirjen e të dhënave elektronike dhe shkatërrimin e materialeve fizike.

5. Grupi i punës i ngritur sipas shkronjës “a”, të pikës 4 të këtij vendimi, bën administrimin dhe evidentimin e:
  - a) dokumentacionit zgjedhor të përcaktuar në nenin 178, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili do t’i dërgohet Arkivit Qendror të Shtetit;
  - b) materialeve që mund të ripërdoren në zgjedhjet e ardhshme;
  - c) materialeve aksesore të pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) që mund të jenë futur gabimisht në kutitë e materialeve zgjedhore;
  - d) fletëve të votimit në kutitë e fletëve të votimit, fletëve të votimit të printuara nga pajisja elektronike e votimit dhe numërimit (PEVN) dhe të çdo dokumenti që nuk klasifikohet në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të kësaj pike.
6. Në përfundim të hapjes së kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, personi i ngarkuar:
  - a) për dokumentacionin e shkronjës “a” të pikës 5 të këtij vendimi, plotëson procesverbalin sipas modelit të lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - b) për materialet e referuara në shkronjat “b”, “c” dhe “d” të pikës 5 të këtij vendimi, plotëson procesverbalin sipas modelit të lidhjes 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe evidenton listën me llojin e materialeve që mund të ripërdoren.
7. Dokumentacioni dhe materiali zgjedhor i cili ka shërbyer si indicie për KQZ-në për të bërë kallëzim penal ruhet dhe administrohet në KQZ për një periudhë kohe sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
8. Fletët e votimit të përdorura në zgjedhje dhe fletët e votimit të printuara nga pajisja elektronike e votimit dhe numërimit (PEVN) asgjësohen sipas legjislacionit në fuqi për trajtimin e mbetjeve.
9. Grupi i punës që plotëson formularët sipas pikave 5 dhe 6 të këtij vendimi ia dorëzon materialet e jo të përdorshme (te dëmtuara) në peshë/ volum/ sasi shefit të sektorit përgjegjës për materialet zgjedhore.
10. Materialet e jo të përdorshme trajtohen sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, të Ministrisë së Financave, “Për menaxhimimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, për materialet e nxjerra jashtë përdorimit. Materialet jo të përdorshme konsiderohen mbetje dhe trajtohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për trajtimin e mbetjeve

11. Materialet e ripërdorshme bëhen hyrje në magazinë me çmimin e daljes duke specifikuar saktësisht procesin për te cilin janë bërë dalje.
12. Në përfundim të procesit të hapjes së kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore grupi i punës harton një raport dhe, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, ia paraqet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
13. Të dhënat biometrike të pajisjeve të identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe dokumentet e printuara nga pajisja PEI me të dhëna sensitive të zgjedhësve do të asgjësohen në përputhje me udhëzimet e posaçme të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
14. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe grupet e punës për zbatimin e këtij vendimi.
15. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
16. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**





## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

LIDHJA 1

### Procesverbal

#### Për:

Seleksionimin e dokumentacionit të gjetur brenda kutive të materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit të KZAZ-së, të përdorura në zgjedhje

#### Baza Ligjore:

Neni 178/6 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pas hapjes së kutive të materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit të KZAZ-së nr. \_\_\_\_\_, u gjet dhe u përzgjedh dokumentacioni si më poshtë :

<b>QARKU:</b> _____	<b>ZAZ:</b> _____	<b>NUMRI I QENDRAVE TË VOTIMIT:</b> _____
------------------------	----------------------	--

#### Dokumentacion:

Nr.	Nr. i QV-së	Lista e Zgjedhësve	Regjistri i posaçëm	Libri i protokollit KQV-së	Procesverbal PV-KQV-07	Procesverbal PV-KQV-08	Raporte PEI	
							Hapja	Mbyllja
1.								
2.								
3.								
4.								
5.								
6.								
7.								
8.								
9.								
10.								

<b>Punonjësi që administron dokumentacionin:</b> Emër /Mbiemër: _____ Firma: _____	<b>Spektori i Materialeve Zgjedhore:</b>  _____ (Emër,Mbiemër,Firmë)
--	---

**LIDHJA 2**

**Procesverbal** i dokumentimit të gjetjeve të materialeve zgjedhore në kutitë e votimit dhe materialeve zgjedhore

Në përfundim të procesit të hapjes së kutive të votimit dhe të materialeve të votimit, pas seleksionimit të materialeve dhe dokumentacionit që ndodhet në to, u gjendën këto materiale:

Nr. Rendor	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia për ripërdorim	Sasia e papërdorshme/ Mbetje
1	Vula KQV			
2	Vula Kryetar KQV			
3	Bexhe plastike dhe lidhese			
4	Kode sigurie të papërdorura			
5	Stilolapsa			
6	Lapsa			
7	Kuti ambalazhi kancelarie			
8	Jelekët staf operator			
9	Dosje			
10	Zarfe te papërdorura			
11	Gërshërë			
12	Vizore			
13	Kodi zgjedhore			
14	Tampon boje/ vule			
15	Natriban			
16	Boje timbruese/ matrikuluese			
17	Kuti Votimi			
18	Kapaku i kutive te votimit			
19	Kuti e materialeve zgjedhore			
20	Kapaku i kutise se materialeve zgjedhore			
21	Kode sigurie plastike te PEI/ PEVN			
22	USB te pajisjeve te PEI			
23	Flamur kombetar			
24	Tjeter:			
25	Tjeter:			

**Konfirmon Grupi i Punës**

---

---

---

---

**Specialisti / punonjësi përpunues:**

---

---

---

---